



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE**  
**KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE**

---

Nr. 65 Prot

Tiranë, më 31.07 2007

VENDIM Nr. 15 dt. 27.07.2007

**Për miratimin e kërkesave për pajisjen me licensë restaurimi**

Në mbështetje të ligjit nr. 9592, datë 27.07.2006, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9048, dt 07.04.2003 "Për Trashëgiminë Kulturore", neni 17, si dhe bazuar në vendimin nr. 8, dt. 16.10.2006 të KKR, për miratimin e rregullores "Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve shqyrtoi dokumentacionin e kërkesës së paraqitur për pajisjen me licensë restaurimi për shoqëri ndërtimi për kategorinë d) **punime restaurimi në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi** dhe konstatoi se:

1. Në testim u paraqit dokumentacioni i shoqërisë së ndërtimit:
  - "G 2 NDËRTIM"Dhe Fondacioni
  - "E shkuara për të ardhmen"
2. Pas shqyrtimit të dokumentacionit rezultoi se shoqëria e ndërtimit plotëson kriteret  
Për këtë arsye Këshilli Kombëtar i Restaurimeve

**VENDOSI:**

**Të pajisë me licensë restaurimi të kategorisë (d), shoqërinë e ndërtimit:**

- "G 2 NDËRTIM"

**Të pritët interpretimi juridik për Fondacionin:**

- "E shkuara për të ardhmen"

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë**

**PROF. DR. YLLI PANGO**

**K R Y E T A R**

**SEKRETAR I K.K.R.**

**LORENC BEJKO**